



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 426/6 prot.

Tiranë, më 30.03.2018

URDHËR

Nr. 448, datë 30.03.2018

PËR

**MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME RASTIN E DITËS PËRKUJTIMORE TË
RËNIES SË PUNONJËSIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA NË KRYE TË
DETYRËS APO PËR SHKAK TË SAJ**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; shkronjës "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 7, të ligjit nr. 10289, datë 17.06.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës" dhe pikës 7, të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 21.10.2010 "Për zbatimin e ligjit nr. 10289, datë 17.06.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e ndihmës financiare, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për çdo vit me rastin e ditës përkujtimore, të rënies së punonjësit të Forcave të Armatosura, në krye të detyrës apo për shkak të saj, për familjarët dhe prindërit, referuar nenit 3, të ligjit nr.10289, datë 17.06.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", i ndryshuar, me të cilët punonjësi i Forcave të Armatosura bashkëjetonte në çastin e humbjes së jetës.

2. Njëri nga familjarët (bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët dhe prindërit bashkëjetues) për përfitimin e ndihmës, dorëzon pranë Ministrisë së Mbrojtjes 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike përpara ditës përkujtimore, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesë për përfitimin e ndihmës sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri;
- b) procesverbalin e referimit nga strukturat përkatëse të rrjedhës së ngjarjes, gjatë së cilës humbi jetën punonjësi në krye të detyrës apo për shkak të saj;
- c) vendimi apo vërtetimi, ku organi i drejtësisë të shprehet që shkak i humbjes së jetës së punonjësit është rënie në krye të detyrës apo për shkak të saj;
- ç) certifikatë e gjendjes familjare të punonjësit në datën e ndodhjes së ngjarjes;
- d) certifikatë vdekjeje e punonjësit;
- dh) dokument identifikimi letërnjoftim ID/pasaportë e subjekteve të përfitimit (bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët dhe prindërit bashkëjetues) që kërkojnë masën e ndihmës me rastin e ditës përkujtimore;
- e) aktperfaqësimi i noterizuar kur njëri nga familjarët përfaqëson familjarët e tjerë, subjekte përfitimi, të interesuar për kërkimin e ndihmës me rastin e ditës përkujtimore.

3. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes:

- a) shqyrton kërkesën, verifikon dokumentacionin e subjektit përfitues dhe përgatit propozimin për dhënien e ndihmës, për miratim ministrit të Mbrojtjes ose ia kthen subjektit përfitues, nëse ka mangësi në dokumentacion, brenda 7 ditëve kalendarike;
- b) pas marrjes së miratimit, përgatit urdhrin në emër të ministrit të Mbrojtjes për dhënien e ndihmës brenda 5 ditëve kalendarike.

4. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në bashkëpunim me Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Qendrën e Personel-Rekrutimit, planifikon çdo vit fondet për përballimin e masës së ndihmës nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Qendra e Personel-Rekrutimit, në bashkëpunim me Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, të dërgojë në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes, të dhëna për punonjësit e Forcave të Armatosura, të rënë në krye të detyrës apo për shkak të saj.

6. Qendra e Personel-Rekrutimit të marrë masa për hedhjen e të dhënave për punonjësit e Forcave të Armatosura të rënë në krye të detyrës apo për shkak të saj, në sistemin e informatizuar të të dhënave të personelit.

7. Shpenzimet financiare për dhënien e masës së ndihmës me rastin e ditës përkujtimore të përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Personel-Rekrutimit.

8. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: Drejtoria e Mirëadmistrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR) dhe Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura.

9. Ndjek zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Formulari nr. 1

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.

KËRKESË

Lënda: Për dhënie ndihme me rastin e ditës përkujtimore të rënies në krye të detyrës apo për shkak të saj të punonjësit të Forcave të Armatosura.

MINISTRISË SË MBROJTJES
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MIRËADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Unë i nënshkruari (emër mbiemër) _____, familjar (bashkëshort/bashkëshorte, fëmijë, prind) i punonjësit të Forcave të Armatosura (emër mbiemër) _____ i rënë në krye të detyrës apo për shkak të saj, në Repartin Ushtarak nr. _____, më (data, muaji, viti) _____, paraqes kërkesën time për dhënien e masës së ndihmës, me rastin e ditës përkujtimore, në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10 289, datë 17. 06. 2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Bashkëlidhur kërkesës sipas formularit nr. 1, është dokumentacioni i kërkuar:

1. procesverbali i referimit nga strukturat përkatëse të rrjedhës së ngjarjes, gjatë së cilës humbi jetën punonjësi i Forcave të Armatosura në krye të detyrës apo për shkak të saj (kopje e noterizuar e vërtetuar me origjinalin);
2. vendimi apo vërtetimi, ku organi i drejtësisë të shprehet që shkak i humbjes së jetës së punonjësit të Forcave të Armatosura është rënie në krye të detyrës apo për shkak të saj (kopje e noterizuar e vërtetuar me origjinalin);
3. certifikatë e gjendjes familjare të punonjësit në datën e ndodhjes së ngjarjes;
4. certifikatë vdekjeje e punonjësit (lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile);
5. dokument identifikimi letërnjoftim ID/pasaportë e subjekteve të përfitimit (bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët dhe prindërit bashkëjetues) që kërkojnë masën e ndihmës me rastin e ditës përkujtimore;
6. aktperfaqësimi i noterizuar kur njëri nga familjarët, përfaqëson familjarët e tjerë, subjekte përfitimi, për kërkimin e ndihmës me rastin e ditës përkujtimore;
7. Numri i llogarisë bankare _____.

Ju faleminderit.

KËRKUESI

(emër mbiemër, firmë)